



Co-funded by  
the European Union

**BELI** Balkan Emerging  
Leaders Initiative



---

### **1. Cili është qëllimi i projektit BELI dhe si do të ndikojë ai në shkollë?**

Qëllimi i projektit BELI është të forcojë pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e vendimmarrjes dhe të avancojë kulturën demokratike në shkolla dhe komunitetet lokale. Projekti ndikon në shkollë përmes forcimit të rolit të këshillit të nxënësve, nxitjes së pjesëmarrjes aktive të nxënësve dhe zhvillimit të aftësive të lidhura me përfaqësimin, demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Shkollat do të kenë mundësi të zbatojnë nisma të udhëhequra nga nxënësit me mbështetje mentorimi, duke kontribuar në një mjedis më aktiv dhe gjithëpërfshirës në shkollë.

---

### **2. Cilat shkolla kanë të drejtë të aplikojnë dhe sa shkolla do të përzgjidhen? A mund të aplikojnë shkollat të cilat nuk e realizojnë mësimin në dy gjuhë?**

Të gjitha shkollat e mesme publike në Maqedoninë e Veriut kanë të drejtë të aplikojnë, pa marrë parasysh nëse mësimdhënia realizohet në një ose më shumë gjuhë. Nga të gjithë aplikantët, do të përzgjidhen tetë shkolla që do të marrin pjesë në projekt. Aplikimi fokusohet në funksionimin dhe potencialin e këshillit të nxënësve, si dhe në gatishmërinë e shkollës për ta mbështetur atë.

---

### **3. Çfarë mbështetjeje do të marrin shkollat e përzgjedhura?**

Shkollat e përzgjedhura do të marrin mbështetje të plotë që përfshin:

- program për ndërtimin e kapaciteteve për anëtarët e këshillit të nxënësve (me prani fizike dhe online),
- mbështetje mentorimi për planifikimin dhe zbatimin e nismave të nxënësve,
- mbështetje në materijale dhe shërbime të siguruara nga QMEQ për realizimin e një nisme,
- pjesëmarrje në dy ngjarje të Rrjetit Rajonal të Liderëve të Rinj dhe një konferencë përfundimtare.

Kjo mbështetje synon të mundësojë zbatimin praktik të njohurive dhe përfshirjen aktive të nxënësve.

---

#### **4. A do të paguhen mentorët? A do të mbulohen shpenzimet e rrugës edhe për mentorin?**

Projekti nuk lejon pagesën e mëditjeve për mësimdhënësit. Megjithatë, të gjitha shpenzimet që lidhen me realizimin e ngjarjeve të Rrjetit Rajonal të Liderëve të Rinj në Shkup dhe Prishtinë, si dhe të ngjarjes përmbyllëse në Beograd, përfshirë edhe shpenzimet e udhëtimit, do të mbulohen nga projekti BELI.

---

#### **5. Çfarë roli ka këshilli i nxënësve në projekt dhe pse është i rëndësishëm?**

Këshilli i nxënësve është elementi kyç i projektit, pasi konsiderohet si mekanizmi i parë institucional përmes të cilit nxënësit përfshihen në proceset demokratike gjatë arsimit të tyre. Përmes projektit, roli i këshillit të nxënësve do të forcohet në përfaqësim, avokim dhe iniciim të aktiviteteve. Shkollat do të realizojnë nisma praktike të udhëhequra nga nxënësit, duke rritur përgjegjësinë dhe rolin aktiv të tyre në shkollë dhe komunitet.

---

#### **6. Cilat janë kushtet kryesore për përzgjedhjen e shkollave?**

Kushtet kryesore për përzgjedhje përfshijnë:

- ekzistencën e një këshilli aktiv të nxënësve,
- motivim për përmirësimin e pjesëmarrjes së të rinjve,
- përfshirjen e nxënësve nga grupet e cenueshme dhe të marginalizuara,
- përvojë në projekte që lidhen me demokracinë dhe edukimin qytetar,
- bashkëpunim të vendosur me partnerë lokalë.

Këto kushte sigurojnë që shkollat e përzgjedhura kanë kapacitet dhe gatishmëri për pjesëmarrje të suksesshme.

---

#### **7. Si plotësohet aplikimi dhe cilat informacione duhet të sigurohen?**

Aplikimi dorëzohet përmes një formulari online në këtë [link](#) dhe përfshin disa pjesë:

- informacione bazë për shkollën (kontakt, lloj, media sociale),
- të dhëna për nxënësit (numri total dhe përqindja e grupeve të cenueshme),
- informacione për këshillin e nxënësve (përbërja, aktivitetet, roli në vendimmarrje),
- motivimi dhe gatishmëria për pjesëmarrje,
- përfshirja dhe pjesëmarrja (sfidat dhe masat mbështetëse),
- përvoja në projekte,
- bashkëpunimi me partnerë lokalë,

- komente shtesë dhe dokumentacion.

Formulari kërkon informacione konkrete dhe të qarta që pasqyrojnë gjendjen reale dhe kapacitetin e shkollës.

---

## **8. Si vlerësohet përfshirja e nxënësve nga grupet e cenueshme dhe të marginalizuara?**

Përfshirja është një nga kriteret kryesore dhe vlerësohet përmes:

- përqindjes së nxënësve nga grupet e cenueshme dhe të marginalizuara,
- përfshirjes së tyre në këshillin e nxënësve,
- masave konkrete mbështetëse (qasja, mentorimi, mbështetja gjuhësore),
- shembujve të aktiviteteve që përfshijnë nxënës me prejardhje të ndryshme.

Kjo tregon se sa aktivisht shkolla punon për barazi dhe pjesëmarrje për të gjithë nxënësit.

---

## **9. Çfarë përvoja duhet të ketë shkolla?**

Projekti synon të ndërtojë kapacitetet e shkollave. Në aplikim, shkolla duhet të paraqesë përvojën e mëparshme në zbatimin e aktiviteteve ose projekteve që lidhen me demokracinë, të drejtat e njeriut, edukimin qytetar ose pjesëmarrjen e të rinjve. Kjo përvojë tregon kapacitetin e shkollës për të realizuar aktivitete dhe për të përfshirë nxënësit në procese mësimore dhe pjesëmarrëse jashtë mësimin të rregullt.

---

## **10. Çfarë bashkëpunimi me partnerë lokalë pritet nga shkolla?**

Nga shkollat pritet të demonstrojnë bashkëpunim me partnerë lokalë si komunat, organizatat e shoqërisë civile dhe trupat rinore. Në aplikim duhet të përshkruhet bashkëpunimi ekzistues dhe shembuj të suksesshëm, si dhe të përmendet nëse shkolla është e njohur me politikën lokale (p.sh. plani lokal i veprimit për të rinjtë). Ky bashkëpunim është i rëndësishëm për lidhjen e shkollës me komunitetin dhe për rritjen e ndikimit të nismave të nxënësve.

---

**11. Cilat janë afatet për aplikim dhe a mund të dorëzojë shkolla më shumë se një aplikacion?**

Aplikimet mund të dorëzohen në çdo kohë brenda periudhës së përcaktuar të aplikimit (nga 23 mars deri më 23 prill 2026). Çdo shkollë ka të drejtë të dorëzojë vetëm një aplikacion. Ky rregull siguron kushte të barabarta për të gjithë aplikantët.

---

**12. A pritet që shkollat të marrin pjesë aktive në monitorimin dhe vlerësimin e projektit?**

Po, nga shkollat pritet të tregojnë gatishmëri për pjesëmarrje aktive në monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të projektit. Në kuadër të aplikimit, shkolla duhet të dëshmojë vullnetin për të ndjekur dhe kontribuar në procesin e vlerësimit, duke përfshirë monitorimin e progresit të nismave dhe pjesëmarrjen në aktivitetet e lidhura me vlerësimin e rezultateve. Kjo është një pjesë e rëndësishme e projektit, pasi siguron zbatim cilësor dhe dukshmëri të rezultateve të arritura.

---

**13. Për shkak të aktiviteteve të planifikuara më herët, përfaqësuesit e shkollës sonë nuk mund të marrin pjesë në info sesionin. Mospjesëmarrja në session a paraqet problem për të aplikuar në thirrje?**

Jo, pjesëmarrja në info sesionin nuk është kusht për të aplikuar. Ajo është vetëm një mundësi shtesë që shkollat të informohen për thirrjen, procesin e aplikimit, aktivitetet e planifikuara dhe të parashtrojnë pyetje shtesë. Shkollat mund të dorëzojnë aplikimin në çdo kohë brenda periudhës nga data e fillimit deri në datën e përfundimit të aplikimit.

---